



VENDIM

Nr.103, Datë 23.06.2016

MBI

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “i” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Traktati i Komunitetit të Energjise Elektrike miratuar me Ligjin nr.9501 dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e “*Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik*”,

Konstatohet se:

- ERE me vendimin nr. 151, datë 11.12.2015, filloi procedurat për miratimin e Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”
- Në komunikim elektronik në datë 18 Janar 2016 ENC ka propozuar një draft të përmirësuar të *Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike.*
- Traktati i Komunitetit të Energjise Elektrike miratuar me Ligjin nr. 9501 vendos ERE-n përpara detyrimit për të përmbushur angazhimet e tij.
- Drafti i propozuar për miratim nga ENC i *Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik*, paraqet vështirësi për implementimin e menjehershëm të ketyre rregullave.

Per gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të miratojë e Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.
2. Kjo Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Deri në hyrjen në fuqi të ketyre rregullave OSHEE sh.a, KESH sh.a. dhe OST sh.a, të operojnë me *Rregulloren procedurave të blerjes nga Kesh sh.a, të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj* miratuar me Vendimin Nr. 30 datë 23.03.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE, *Rregullat e shitjes së energjisë elektrike*, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 1, datë 10.01.2011, si dhe *Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 100 datë 27.12.2006, i ndryshuar.
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.103, Datë 23.06.2016

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR
BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT
PUBLIK**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____

**RREGULLORE PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENEGJISË ELEKTRIKE PËR
TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK**

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 nenit 19, gërma “l” nenit 62, pika 2, nenit 69, gërma “ë” datë 28.05.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM 244 Datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”,

Neni 2

Objekti dhe qëllimi

1- Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike sipas Nenit 6 më poshtë nga operatori i sistemit të shpërndarjes, operatori i sistemit të transmetimit dhe cdo kompani tjetër e energjisë elektrike për të cilën janë vendosur detyrimet e shërbimit publik (PSO) nga kompanitë e licensuara për tregëtimin e energjisë elektrike.

2- Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- a. të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike për kompanitë e energjisë elektrike të cilave iu jemi referuar në paragrafin 1 të këtij neni për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët;
- b. të sigurojë blerje të energjisë elektrike me cmime sa më të ulëta
- c. të nxisë pjesëmarrjen e tregëtarëve në procesin e blerjes së energjisë elektrike;
- d. të nxisë konkurrencën në procesin e blerjes së energjisë elektrike;
- e. të sigurojë transparence si dhe një trajtim të barabartë për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e blerjes së energjisë elektrike;

- f. të përputhet me legjislacionin në fuqi

Neni 3

Parimet

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje do të realizohen në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 4

Përcaktime

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

- 1. ERE:** nënkupton Entin Rregullator të Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjet 43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike” dhe Ligjin 102/2015 “Per sektorin e gazit natyror” dhe aktet nënligjore në fuqi.
- 2. Blerësi:** nënkupton operatorin e sistemit të shpërndarjes, operatorin e sistemit të transmetimit, dhe kompani të tjera të energjisë elektrike për të cilat është vendosur Detyrimi i Shërbimit Publik (PSO) për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike sipas licensave të lëshuara nga Enti Rregullator i Energjisë.
- 3. Blerje e energjisë elektrike:** do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike nga tregtarët e energjisë elektrike dhe/ose Bursat energjetike tek Blerësi, sipas pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shit-blerjes, dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
- 4. Tregtar i energjisë elektrike:** do të thotë cdo person juridik/kompani vendase apo e huaj që ushtron aktivitet të licensuar, për tregtimin e energjisë elektrike me shumicë.
- 5. Kërkesa/Ftesa për ofertë:** do të thotë dokumenti zyrtar që Blerësi u drejton publikisht tregtarëve të energjisë elektrike për paraqitje të ofertave, hartuar në formën e parashikuar në këtë rregullore
- 6. Kodeve të Funkcionimit të Rrjetit** do të thotë Kodi i Rrjetit të Transmetimit, Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, Kodi i Matjes.
- 7. Ofertues:** do të thotë Tregtari i energjisë elektrike që paraqet një Ofertë.
- 8. Ofertë:** do të thotë tërësia e informacionit, dhe korrespondencës të dërguar në mënyre elektronike administruar nga Blerësi sipas rregullave në fuqi.
- 9. Kalendari i Ofertave:** do të thotë kalendari i cili përfshin të gjitha ditët të cilat drejtojnë proceset e blerjes për 12 muajt në vazhdim. Ai do të përditësohet cdo muaj dhe do të vendoset në

dispozicion të publikut. Cdo ndryshim në kalendarin e ofertave duhet t'u njoftohet në kohë të gjithë tregtarëve të licensuar nga ERE dhe të regjistruar në tregun e energjisë elektrike në përputhje me Rregullat e Tregut.

10. Regjistri i tregtarëve të Energjisë Elektrike: do të thotë një regjistër të të gjithë tregtarëve të Energjisë Elektrike i cili mbahet nga Bleresi, me kontaktet e personave përgjegjës për të siguruar informacionin për procesin e blerjes.

11. Terma komerciale: janë tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me kushtet teknike, sasinë, cmimet e shit-blerjes, lëvrimin, kapacitetet e interkonjeksionit si dhe tarifat ose pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e blerjes.

12. Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit: janë kapacitetet e interkonjeksionit të cilat sigurohen nga blerësit dhe/ose tregtarët, për të mundësuar blerjen e energjisë elektrike.

13. Një platformë IT online do të thotë, një platforme elektronike e publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike.

Neni 5

Përgjegjësitë

Blerësi është përgjegjës për përcaktimin e grafikut të fuqisë në MW dhe atë të energjisë elektrike në MWh përkatësisht (në kapacitet dhe sasinë e energjisë elektrike) si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj, që duhet të llogaritet në përputhje me Ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike si dhe Kodeve të Funksionimit të Rrjetit.

Neni 6

Zbatimi

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike të përcaktuara në këtë rregullore duhet të zbatohen:

- a. Nga Operatori i sistemit të shpërndarjes dhe operatori i sistemit të transmetimit për të mbuluar humbjet respektivisht në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit ;
- b. Nga kompanitë e energjisë për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike;
- c. Në rastin e blerjes së energjisë elektrike në kushte emergjente, përfshirë dhe pa u kufizuar tek avaritë e ndodhura në njësinë e shpërndarjes ose transmetimit të energjisë elektrike.

Neni 7

Formati i mbledhjes, paraqitjes dhe shqyrtimit të ofertave

1. Një platformë IT online duhet të përdoret nga Blerësi për të gjitha ndërveprimet me tregtarët e Energjisë Elektrike në procesin e Blerjes. Ajo duhet të vendoset në dispozicion on-line.
2. Blerësi duhet të drejtojë Kalendarin e Ofertave dhe Regjistrin e tregtarëve të Energjisë Elektrike. Të gjitha ofertat, koha e paraqitjes dhe detajet e ofertës duhet të ruhen në sistem për një afat 5 vjeçar.
3. Paraqitja e ofertave nga tregtarët e Energjisë Elektrike, behet online në sistem sipas një hyrje të paracaktuar në ditën e paraqitjes së ofertave. Koha e hapjes dhe e mbylljes duhet të publikohen në Kalendarin e Ofertave.
4. Shqyrtimi i plotësimit të ofertave dhe vlerësimi I tyre, duhet të bëhet në mënyrë automatike përmes sistemit online të IT. Rezultatet e procedurave të tenderimit duhet të paraqiten në mënyrë automatike në **ERE** për shqyrtim dhe duhet të përmbajnë tregtarët e Energjisë Elektrike të cilët kanë paraqitur ofertat, të gjithë informacionin në dispozicion të ofertave të marra dhe ofertat e përzgjedhura.
5. Bleresi nepermjet Sistemit online te IT duhet të publikojë rezultatet e Blerjes në mënyrë anonime dhe të grumbulluar, me cmime mesatare dhe sasi të blera për procedurat e Blerjes.

Neni 8

Formati i ofertave

1. Të gjitha ofertat e paraqitura në platformën online të blerjes për cdo proces prokurimi /blerje duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:
 - emrin e ofertuesit;
 - kapacitetin e ofruar/periudhen në (MW);
 - cmimin/njësine/periudhen (Euro/MWh);
2. Të gjitha ofertat duhet të jenë të pandryshueshme dhe të paraqiten për të gjithë

periudhën për të cilën është prokuruar energjia elektrike. Kapaciteti i ofertave duhet të jetë midis 1 MW dhe kapacitetit total i siguruar për periudhën respektive.

3. Cdo proces prokurimi duhet të ketë një periudhë fikse për livrimin dhe një kapacitet fikse të prokuruar, për të gjithë periudhën që rezulton nga një sasi maksimale që mbulohet nga procesi i prokurimit. Kur mënyra e prokurimit parashikon kërkesa të ndryshme gjatë kësaj periudhe, duhet të organizohen prokurime të vecanta me periudha fikse livrimi dhe kapacitete fikse. Kjo nuk duhet të dëmtojë mundësinë e tregëtarëve të energjisë elektrike për të paraqitur oferta të cilat janë më pak se kapaciteti maksimal që është siguruar.

Neni 9

Kontratat për blerjen e energjisë elektrike

1. Blerja ose shitja e energjisë elektrike nga kompanitë e energjisë të cilave iu jemi referuar në Nenin 2(1) të Regullores kryhet mbi bazë të kontratave që lidhen si rrjedhojë e procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kontratat duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të sektorit të energjisë elektrike dhe atë civil.
3. Pika e livrimit gjithmonë duhet të jetë grupi i balancimit për Blerësin sipas zonës detyruese Shqiptare.

Neni 10

Publikimi i informacionit për blerjen e energjisë elektrike

- 1- Për secilën blerje të energjisë elektrike, i gjithë informacioni specifikuar në paragrafin 2 më poshtë duhet të publikohet në Kalendarin e Ofertave i cili duhet të vendoset në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut nga Blerësi përmes platformës on-line.
- 2- Informacioni për cdo proces tenderimi dhe proces detyrues duhet të publikohet përmes platformës on-line të paktën duhet të përmbajë:
 - Sasinë e përgjithshme të energjisë elektrike në MWh që kërkohet për t'u blerë në cdo proces prokurimi/blerje të energjisë elektrike;
 - Kapacitetin maksimal të energjisë elektrike në MW që mund të ofrohet për cdo proces prokurimi/blerje;
 - Periudhën e plotë kohore të livrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale të (shit-blerjes);
 - Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
 - Kërkesat për kualifikimin në procedurën e blerjes sic parashikohet në nenin 10;

- Kriterin ose vlerësimin e ofertave në përputhje me Nenin 12;

- Kushtet e pagesave;

3- Blerësi duhet të publikojë cdo informacion të përfshirë në Kalendarin e Ofertave në gjuhën Shqipe dhe Angleze në faqen zyrtare të Blerësit. Në rast mospërputhjes duhet të mbizotërojë informacioni në gjuhën shqipe.

4- Brenda një dite pune pas përfundimit të procesit të blerjes së energjisë elektrike, në Platformën e IT për Blerjet, duhet të publikohet informacioni i mëposhtëm.

- Emrat e ofertuesve;
- Kapacitetet e ofruara për cdo ofertë (MW);
- Sasitë e ofruara për cdo ofertë (MWh);
- Cmimi /njësia për cdo (Euro/MWh);
- Vlera totale për cdo proces blerje (Euro);
- Profilet e livrimit për cdo ofertë;
- Pikat e livrimit të energjisë elektrike për cdo ofertë;
- Vlefshmëria e të gjitha ofertave;
- Shpallja e fituesve dhe/ose kompanive që nuk janë fituese;

5- Blerësi duhet të publikojë në faqen zyrtare të internetit një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura si dhe të përgjigjeve për ankesën.

Neni 11

Dokumentacioni Ligjor dhe Administrativ

1- Cdo shoqëri e licensuar për tregtimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe/ose cdo Palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që dëshiron të marrë pjesë në procedurën e blerjes së energjisë elektrike duhet ti paraqesë Blerësit, dokumentacionin e nevojshëm administrativ që vërteton aftësinë e tij ligjore si dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku është rregjistruar, si më poshtë vijon:

- a. Dokumentacionin që vërteton rregjistrimin e shoqërisë në rregjistrat përkatës tregtarë\gjyqësore të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo rregjistruar.
- b. Licensën për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për tregtarët të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet përkatëse për ata Tregtarë të energjisë elektrike të cilët janë krijuar apo rregjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë.
- c. Dokumentacionin lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës **jo më vonë se 3**

muaj që nga paraqitja e ofertës I cili duhet të vërtetohet që:

- Tregtari nuk është në proces falimentimi (dokument i lëshuar nga QKR)
- Tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për shkelje penale
- Tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike;

2- Këto kërkesa duhet të përmenden në mënyrë të qartë në njoftimin publik ku ftohen për të paraqitur kërkesat.

3- Tregtarët që nuk i përmbushin kërkesat e vendosura në paragrafin 1 duhet të konsiderohen si jo të përshtatshëm për të dhënë ofertë.

4- Tregtarët që shprehin për herë të parë interesin e tyre për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të zhvilluar nga Blerësi, të cilët nuk kanë depozituar dokumentacionin ligjor të cilit i jemi referuar në paragrafin 1 (c) të këtij Neni, duhet të paraqesin dokumentacionin e mësipërm përmes platformës online së bashku me dokumentacionin e shprehjes së interesit.

5- Kompanitë e tjera të interesuara, të cilat janë të regjistruara për të ofertuar me Blerësin, në ndonjë procedurë blerje në të ardhmen, duhet të paraqesin vetëm formatin e ofertës me të dhënat e specifikuara në Nenin 8(1) të kësaj Regulloreje,

6- Blerësi nuk duhet të refuzojë kompanitë të cilat kanë paraqitur dokumentacionin e plotë, edhe nëse ai është paraqitur me pjesë, për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Neni 12

Kriteret për vlerësimin e ofertave

Platforma e IT online për prokurimin/blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve apo energjinë që ka vendosur Detyrimi i Shërbimit Publik (PSO) për blerësin duhet të vlerësojë ofertat e ardhura në mënyrë automatike me kohën e hapjes/mbylljes bazuar vetëm në cmimin për MWh. Platforma e IT duhet të zgjedhë të gjitha ofertat për të minimizuar kostot për çdo proces prokurimi duke bërë fitues ato oferta të cilat grumbullohen sipas rezultatit më të ulët të përgjithshëm për procesin. Në rastin kur ofertat kanë të njëjtën sasi dhe cmim duhet të aplikohet parimi i pari që vjen i pari shërbehet (**first-come-first serve**)

Neni 13

Komunikimi i Blerësit me pjesëmarrësit në procedurat për blerjen e energjisë elektrike

1. Cdo komunikim i Blerësit me shoqëritë pjesëmarrëse në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë, do të bëhet vetëm përmes platformës e IT online për prokurimin, pas regjistrimit të tregtarëve të energjisë elektrike.
2. Të gjitha njoftimet që ndryshojnë kalendarin e ofertave duhet të bëhen me shkrim dhe të publikohen në faqen e internetit të Blerësit. Duhet të ndalohet cdo formë tjetër komunikimi ose negociimi midis Blerësit dhe tregtarëve të Energjisë Elektrike ose midis tregtareve të Energjisë elektrike me njëri tjetrin.

Neni 14

Procedura e prokurimit të energjisë elektrike

1. Blerësi duhet të zhvillojë një strategji/mënyrë prokurimi të energjisë për të gjithë sasinë e humbjeve të parashikuara në rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit, ose të parashikojë energjinë që ka vendosur Detyrimi i Shërbimit Publik (PSO) për Blerësin, përgjatë gjithë vitit kalendarik. Ai duhet të përditësojë mënyrën e prokurimit të energjisë të paktën në baza mujore.
2. Të gjitha ndryshimet në strategjinë/mënyrën e prokurimit të energjisë elektrike i cili ndikon në mënyrë direkte në sasinë dhe frekuencën e blerjes që con në një ndryshim në procesin e blerjes duhet të përfshihet në kalendarin e ofertave brenda një dite.
3. Mënyra/strategjia e prokurimit të energjisë ka si qëllim minimizimin e kostove për energjinë e prokuruar për gjatë gjithë vitit kalendarik.
4. Mënyra/strategjia e blerjes dhe përfaqësimi i saj në kalendarin e ofertave duhet të përmbajë:
 - 7- sasinë e energjisë elektrike në MWh që do të blihet;
 - 8- periudhën dhe ditën e blerjes;
 - 9- grafikun ditor të livrimit të energjisë elektrike;
 - 10- kohëzgjatjen e livrimit të energjisë elektrike;
 - 11- datën/orën e paraqitjes së ofertave;
5. Cdo paraqitje e ofertes për blerjen e energjisë elektrike nga cdo ofertues duhet të kryhet përmes platformës së IT online për prokurimin /blerjen e energjisë elektrike.

6. Vlerësimi i ofertave duhet të zhvillohet në mënyrë automatike në përputhje me Nenin 12 të kësaj Regulloreje. Rregullat për vlerësimin duhet të publikohen në faqen zyrtare të Blerësit dhe në platformën e IT.

7. I gjithë informacioni bashkalidhur procedurës së Blerjes së energjisë elektrike së bashku me kontratën e nënshkruar nga Blerësi dhe ofertuesi/ofertuesit fitues, duhet të dokumentohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Ai duhet të paraqitet në ERE sipas Nenit 19 të Regullores.

Neni 15

Përsëritja e Procesit të Ofertës

1. Në rastin kur më pak se tre tregtare kanë paraqitur ofertat, procesi do të përsëritet.
2. Kur rishikimi, vlerësimi dhe krahasimi nga Blerësi nuk është i mundur për shkak të formatit të informacionit të ofertës dhe/ose kur informacioni kërkon sqarim nga ofertuesi, oferta skualifikohet. Nëse numri i ofertave pas skualifikimeve të mundshme është më poshtë se tre, procesi do të përsëritet serish.
3. Përsëritja e procesit të ofertimit duhet të njoftohet për të gjithë tregtarët e Energjisë Elektrike dhe të publikohet në platformën on-line dhe faqen zyrtare të Blerësit. Përsëritja e procesit duhet të kryhet të paktën dy ditë pas fillimit të procesit të ofertimit dhe dy ditë pas periudhës së njoftimit.

Neni 16

Deklarata e konfliktit të interesave

Para se të fillojë funksionimi i platformës së IT, çdo punonjës i Blerësit që i është ngarkuar vendosja në funksion dhe ecuria e platformës së IT duhet të nënshkruajë deklaratën, sipas të cilës ai/ajo duhet të shprehë mungesën e konfliktit të interesit me ofertuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 17

Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

1. Njoftimi i fituesit, i jepet ofertuesit/ve, që ka/kanë paraqitur ofertat fituese në përfundim të

procesit të vlerësimit të ofertave. Njoftimi i fituesit të paktën përmban:

- emrin, adresën e ofertuesit;
- periudhën e furnizimit me energji elektrike;
- profilin e furnizimit me energji elektrike;
- sasinë, cmimin/njësi dhe vlerën e kontratës;

2. Pas shpalljes së fituesit, Blerësi dhe ofertuesi i shpallur fitues nënshkruajnë kontratën.

Neni 18

Procedura administrative e ankimit

1. Cdo ofertues mund të kërkojë rishikim e procedurës administrative e cila ndiqet për një blerje, kur gjykon se një vendim i Blerësit është në kundërshtim me këtë Rregullore, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

a. Ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim përmes platformës online ose me e-mail Blerësit, brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të skualifikuar ose duke u ankuar për shkeljen.

b. Në këtë ankesë, ankimesi duhet të paraqesë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar.

c. Kur merr një ankesë, Blerësi është i detyruar të miratojë vendimin për pranimin ose jo të ankesës brenda 24 orësh nga marrja e ankesës.

d. Kur ankimesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga Blerësi, brenda 5 ditëve pune i drejtohet ERE për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 24 të Ligjit për Sektorin e Energjisë.

e. Kur ankimesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga ERE, ajo mund të kundështojë vendimin e ERE në gjykatë.

Neni 19

Monitorimi i blerjes së energjisë elektrike

1. Të gjitha veprimet e blerjes së energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë blerje

nuk do të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar.

2. Deri në datën 5 të cdo muaji, Blerësi paraqet në ERE një kopje të raportit përmbledhës përfundimtar për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe një kopje të gjithë ankesave të paraqitura, nëse ka, si dhe përgjigjet për ankesat.
3. Blerësi është i detyruar të paraqesë në mënyrë transparente në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar, për blerjet e energjisë elektrike brenda autoritetit të ERE-s për monitorim.
4. ERE shqyrton të dhënat e paraqitura nga Blerësi dhe vlerëson nëse procesi i ofertës në muajin pararendës përputhet me kriteret dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.
5. Në rast se ERE shikon parregullsi në proceset e ofertave të cilat mund ti ngarkohen Blerësit dhe ofertuesve, ERE mund të vendose një masë administrative mbështetur në nenin 20 të Ligjit nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”.

Neni 20

Pagesat, faturimi, gjetja e zgjidhjes

1. I gjithë procesi për gjetjen e një zgjidhjeje do të kryhet brenda 10 ditëve pune pas periudhës së livrimit për cdo blerje të kryer. Pagesa dhe faturimi duhet të bëhet në mënyrë të vecantë për cdo javë kalendarike.
2. Blerësi duhet t’u kalojë cmimin e blerjes tregtarëve të Energjisë Elektrike brenda tre ditë pune pas përfundimit të javës e cila ka pasur ndonjë livrim.
3. Cdo ditë ose periudhë livrimi më e vogël se kjo, në rast se periudha e livrimit për blerjen është më e shkurtër, duhet të jetë i paraqitur si zë më vete në faturë. Faturimi duhet të nxirret nga platforma e IT dhe do t’i faturohet Blerësit.

Neni 21

Rishikimi

Këto Rregulla janë objekt rishikimi me vendimin e Bordit të ERE-s, sipas Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ere-s

Neni 22

Sanksione

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale, ERE vepron në përputhje me nenin 107, të Ligjit Nr. 43/2015, datë 28.05.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar.

Neni 23

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.